



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

VENDIM

Nr. 42, datë 26.03.2026

PËR

“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË PIKËS 1 TË MARRËVESHJES NR. 10216/1 PROT. DT. 25.11.2022 NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A. PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT TATIMOR”

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, bazuar në dispozitat e Kodit Civil, nenin 9/1.3 pika b, 1.4, 1.6, 35 54/ë/f, 64/c të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 5, 23/1 të Ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjt Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI

1. Të miratojë ndryshimin e nenit “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 1, të marrëveshjes Nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë e cila do këtë përmbajtjen si më poshtë vijon:

“Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë, është agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Korçë si më poshtë vijon:

- **Taksa mbi ndërtesën**, për të gjithë familjarët që disponojnë pasuri në territorin e Bashkisë Korçë, përfshirë njësitë administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë, Vithkuq dhe Lakas, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A.;
- **Tarifa për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin publik, si dhe mirëmbajtjen e varrezave**, për të gjithë familjarët në territorin e Bashkisë Korçë dhe njësite administrative përkatëse sipas tarifave përkatëse, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A., sipas tarifave përkatëse.
- **Taksa mbi tokën bujqësore**, për të gjithë familjarët që disponojnë tokë bujqësore në territorin e Bashkisë Korçë dhe njësite administrative përkatëse, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A.;
- **Tarifa vjetore për shërbimin e mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues**, për të gjithë familjarët që disponojnë tokë bujqësore në territorin e Bashkisë Korçë dhe njësite administrative përkatëse, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sh.A..
- **Taksa mbi truallin** për të gjithë familjarët të cilët disponojnë një truall në Bashkisë Korçë apo dhe në Njësitë Administrative (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë, Vithkuq dhe Lakas) të cilët kanë të lidhur një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me SHRUKKO.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kundër 5

Vota Abstenim 0

Zbardhur në dt: 26.03.2026

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË
BURIMEVENJERËZORE**

BASHKIA KORÇË

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME
KORÇË SH.A.**

Nr. _____ prot.

Nr. _____ prot.

(Korçë), më 21.03.2026

(Korçë), më _____.03.2026

ANEKS III

PËR

**“NDRYSHIMIT TË PIKËS 1 TË MARRËVESHJES NR. 10216/1 PROT. DT. 25.11.2022
NËNSHKRUAR MIDIS BASHKISË KORÇË DHE SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS
KANALIZIME KORÇË SH.A. PËR ZGJEDHJEN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS
KANALIZIME KORÇË SH.A SI AGJENT TATIMOR”**

NENI I

OBJEKTI I ANKESIT

Ky aneks ka për objekt ndryshimin e pikës 1 të marrëveshjes nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 të ndryshuar me VKB Nr. 49 dt. 30.03.2023 “Për miratimin e ndryshimit të pikës 5 të marrëveshjes Nr. 10216/1 Prot. dt. 25.11.2022, nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë sh.a. për zgjedhjen e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë sh.a si agjent tatimor”.

NENI II

BAZA LIGJORE

Kodit Civil, nenin 9/1.3 pika b, 1.4, 1.6, 35 54/ë/f, 64/c të Ligjit 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 5, 23/1 të Ligjit Nr. 9632 dt 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, Ligjt Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKB Korçë Nr. 190 dt 28.12.2022 “Për miratimin e marrëveshjes midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A. për zgjedhjen e shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A si agent tatimor”, VKB Nr. 49 dt. 30.03.2023 “Për miratimin e ndryshimit të pikës 5 të marrëveshjes Nr. 10216/1 Prot. dt. 25.11.2022 dhe VKB 26 dt. 29.02.2024 Për “Miratimin e ndryshimit të pikës 1 të marrëveshjes nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a. për zgjedhjen e shoqërisë si agent tatimor”,

NENI III

NDRYSHIMET

Neni “Të drejtat dhe detyrimet e palëve”, pika 1, e marrëveshjes Nr. 10216/1 prot. dt. 25.11.2022 nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë ndryshohet dhe do të këtë përmbajtjen:

“Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë, është agjenti tatimor i ngarkuar për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Korçë si më poshtë vijon:

- **Taksa mbi ndërtesën**, për të gjithë familjarët që disponojnë pasuri në territorin e Bashkisë Korçë, përfshirë njësitë administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë, Vithkuq dhe Lakas, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A.;

- **Tarifa për pastrimin, gjelbërimin dhe ndriçimin publik, si dhe mirëmbajtjen e varrezave**, për të gjithë familjarët në territorin e Bashkisë Korçë dhe njësite administrative përkatëse sipas tarifave përkatëse, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A., sipas tarifave përkatëse.

- **Taksa mbi tokën bujqësore**, për të gjithë familjarët që disponojnë tokë bujqësore në territorin e Bashkisë Korçë dhe njësite administrative përkatëse, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Korçë Sh.A.;

- **Tarifa vjetore për shërbimin e mirëmbajtjes së rrugëve të parcelave dhe sistemit kullues,** për të gjithë familjarët që disponojnë tokë bujqësore në territorin e Bashkisë Korçë dhe njësive administrative përkatëse, të cilët kanë lidhur kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me Shoqërinë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A..
- **Taksa mbi truallin** për të gjithë familjarët të cilët disponojnë një truall në Bashkinë Korçë apo dhe në Njësiti Administrativ (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskop, Voskopojë, Vithkuq dhe Lakas) të cilët kanë të lidhur një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm me SHRUKKO.

NENI IV

DISPOZITAT E FUNDIT

Të gjithë të drejtat dhe detyrimet e palëve dhe parashikimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen Nr. 10216/1 Prot dt. 25.11.2022 “Për zgjedhjen e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A. si agent tatimor, për mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore familjare të Bashkisë Korçë”, ndryshuar me VKB Nr. 49 dt. 30.03.2023 “Për miratimin e ndryshimit të pikës 5 të marrëveshjes Nr. 10216/1 Prot. dt. 25.11.2022”, nënshkruar midis Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A. ngelen të pandryshuara dhe në fuqi.

Ky aneks hartohet në aq kopje origjinale sa është hartuar Marrëveshjen Nr. 10216/1 Prot dt. 25.11.2022 dhe i bashkangjitet marrëveshjes për vlefshmërinë e saj.

Ky aneks/ ndryshim hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga palët.

PËR

BASHKINË KORÇË

PËR

**SHOQËRINË RAJONALE UJËSJIJELLËS KANALIZIME
KORÇË SH.A.**

KRYETARI

ADMINISTRATORI

Sotiraq Filo

Petrit Tare